



Prishtinë, datë: 16.08.2023

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Në bazë të Ligjit me Nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me Nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit të Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, në lidhje me aktvendimin me numër të protokollit 1028 dt. 06.04.2022 ndaj: Remzi Thaçi me numer personit fizik nr; personal 1013487274 me adresë; Dublibare,Gjakovë merr këtë:

AKTVENDIM

1. Dorëzimi i mëtejshme i i te gjitha shkresave dhe parashtrësive për Remzi Thaçi , me nr. personal 1013487274 me adresë; Dublibare,Gjakovë , tani e tutje do të bëhet me afishimin e tyre në tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit të afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

Arsyetim

Ndaj; Remzi Thaçi , me nr. personal 1013487274 me adresë; Dublibare,Gjakovë, është lëshuar aktvendimi me numër të protokollit 1028 dt. 06.04.2022.

Në tentim që t'i dorëzohet akti administrativ ne përputhje me nenin 7 par. 3 të Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt.06.04.2022 dhe me dt.27.06.2023 , është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrativ


Sali Mulaj
Zëvendësues i Drejtorit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale





Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE (KPMM) në pajtim me nenin 79 paragrafi 3, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet, ndaj: personit fizik Remzi Thaqi me nr. Personal 1013487274 me seli; Dublibare, Gjakovë, në procedurë administrative me datë 06.04.2022 nxjerr këtë:

AKTVENDIM

1. Ndaj: personit fizik Remzi Thaqi me nr. Personal 1013487274 me seli; Dublibare, Gjakovë,
2. Në pajtim me nenin 79 parag.3 i shqiptohet gjoba administrative lidhur me trefishin e sasisë prej 318.58m³ për mineralet e përpunuara, seperuara, shfrytëzuara ose eksploatuara të rërës dhe zhavorrit në shumën prej 1,194.66 €.
3. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 shqiptohet gjoba administrative për zhvillimin e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar pa posedimin Lejes për Aktivitet të Veçanta në shumën prej 5,000.00 € (pesë mijë euro).
4. Dhe në pajtim me nenin 79 paragrafi 5 shqiptohet gjobë administrative në mënyrë kumulative (grumbulluese) lidhur me paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni në shumën e përgjithshme prej 6,194.66€
5. Pala ka 15 ditë afat nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi që të kryejë pagesën e shumës së përcaktuar në pikën 4 të dispozitivit në këtë xhirollogari 1000430070005950.

Arsyetim

Inspektorati i KPMM-së, gjatë inspektimit të aktiviteteve të jashtëligjshme minerare me datën 23.03.2022 në bazë të autorizimeve dhe obligimeve që dalin nga Ligji Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale ka konstatuar se personi fizik Ramiz Thaqi, me nr. Personal 1013487274 është duke ushtruar aktivitet të jashtëligjshëm minerar, dhe ju është lëshuar urdhëresa për ndërprerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar. Inspektimi është bërë në lokacionin e objektit minerar në zonën kadastrale Dublibare, Komuna e Gjakovë.

Gjatë inspektimit Inspektorët e Minierave kanë konstatuar se personi fizik Ramiz Thaqi, është duke kryer aktivitet të jashtëligjshëm minerar pa posedimin e Lejes për Aktivitete të Veçanta – Seperacioni i cili është në kundërshtim me dispozitat materiale të pjesës së VI (gjasthtë) të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minalet, duke pasur parasysh faktin se në radhë të parë personi që dëshiron të ndërmarrë aktivitete të veçanta duhet të pajiset me lejen për kryerjen e aktiviteteve të veçanta dhe se vetëm atëherë do të mund ti ndërmarr aktivitetet minerare që përfshihen nga të drejtat dhe detyrimet e lejes së veçantë e cila do ti jepte bartësit të lejes të drejtën ekskluzive duke iu nënshtruar kushteve dhe dispozitave të asaj leje.

Personi në fjalë duke mos poseduar Leje për Aktivitete të Veçanta dhe njëherë duke zhvilluar aktivitet të përpunimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorr për të cilat resurse minerale nuk i

dihet prejardhja e tij, nuk posedon as Licencë të Shfrytëzimit gjë që është në kundërshtim edhe me pjesën V (pestë) të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, të ndërlidhura me nenet 22, 23, 24,25, 26, 27 të Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, pasi që personi i cili dëshiron të ndërmarrë aktivitete të shfrytëzimit ose eksploatimit të burimeve minerale në Kosovë duhet të pajiset me licencën në fjalë dhe pastaj do të mund ti ndërmarrë aktivitetet minerare që përfshihen nga të drejtat dhe detyrimet e licencës së shfrytëzimit e cila do ti jepte bartësit të licencës të drejtën ekskluzive që të kryejë aktivitetet e specifikuar të shfrytëzimit të mineraleve përkatëse duke iu nënshtruar kushteve dhe dispozitave të asaj licence.

Inspektorati i KPMM-së, gjatë inspektimit ka përcaktuar edhe lokacionin me koordinata ku personi fizik RamizThaqi ishte duke ushtruar aktivitet të jashtëligjshëm minerar, si dhe ka përcaktuar llojin e mineralit të rërës dhe zhavorrit që jeni hasur duke seperuar dhe shfrytëzuar në mënyrë të jashtëligjshme.

Inspektorët e Minierave kanë konstatuar se personi fizik Ramiz Thaqi, aktivitetin e operimeve të jashtëligjshme minerare e zhvillonte në lokacionin e zonës në këto koordinata

Nr.	X	Y	Z
1.	4699333.455	7460148.296	378.7295

Në lidhje me këto koordinata personit fizik Ramiz Thaqi, nuk ka poseduar Leje për Aktivitete të Veçanta të lëshuar nga organi kompetent i KPMM-së.

Makineria e angazhuar në kryerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar në vendin e ngjarjes ishte:

- Seperacion statik i rërës dhe zhavorrit.

- Luga ngarkuese Liebherr 564.

-Një kamion i ngarkuar me rëre dhe zhavorr.

Personi në fjalë ditën e inspektimit është urdhëruar me anë të urdhëresës për ndërprerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar dhe sekuestrimin e mjeteve të punës të lëshuar nga Inspektorët që menjëherë të ndërpres aktivitetin e jashtëligjshëm minerar.

Me datë 29.03.2022 Departamenti i Gjeodezisë i KPMM-së, ka kryer matjet gjeodezike të ndërmarrja fizik Ramiz Thaqi, në të cilin vend ishte ushtruar aktiviteti i jashtëligjshëm në sipërfaqe prej $S=213.445m^2$ dhe e cila sasi e mineraleve të shfrytëzuara është $V=318.575m^3$.

Duke pasur parasysh faktin që Inspektorati i KPMM me rastin e inspektimit ka konstatuar se personi në fjalë nuk ka poseduar Leje për aktivitete të veçanta dhe Licencë të Shfrytëzimit dhe se aktiviteti minerar është i jashtëligjshëm dhe është në kundërshtim me dispozitat materiale të pjesës së VI (gjashtë) të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, përkatësisht pjesës së V (pestë) të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, të ndërlidhura me nenet 22, 23, 24,25, 26, 27 të Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, dhe me këtë raste në përputhje me nenin 79 paragrafi 3, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet i shqiptohet gjoba administrative.

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ky akt administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit nga Drejtori i KPMM-së.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njoftimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit Shqyrtues për Ankesa të KPMM-së.

Aktvendimi i dërgohet:

- Arkivit të KPMM-së,
- Departamentit të Financave të KPMM-së,
- Palës.

